



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

DREJTORIA E MBROJTJES SOCIALE DHE POLITIKAVE TË ARSIMIT

Nr. 27891 Prot.

Patos, më 16/09/2025

**MIRATOHET
KRYETARI
FATION DURO**

PROJEKTVENDIM

Nr. 59 Datë 16/09/2025

PËR

**MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË NXËNËSVE TË SHKOLLËS “SOTIR
ÇAPO”, ZHARRËZ**

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në pjesën V “Kontratat” dhe kreu VI “Qiraja” të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994, i ndryshuar, në shkresën e miratimit të financimit të projektit “Rikonstruksion i shkollës "Sotir Çapo" dhe ndërtimi i palestrës nr. 2174/1 prot., datë 09.04.2025, në V.K.B Patos nr. 23 datë 26.05.2025, “Për miratimin e projektit me objekt “Rikonstruksion i shkollës "Sotir Çapo" dhe ndërtimi i palestrës” dhe bashkëfinancimin nga Ministria e Arsimit dhe Sportit,

KËRKOJMË

1. Të miratojë transferimin dhe transportin e nxënësve nga shkolla e bashkuar “Sotir Çapo”, Zharrëz në shkollën “Koli Dimo”, Frashër dhe anasjelltas.
2. Të miratojë fondin prej 1,123,200 (një milion e njëqind e njëzetë e tre mijë e dyqind) lekë për mbulimin e transportit të 108 (njëqind e tetë) nxënësve nga shkolla e bashkuar “Sotir Çapo”, Zharrëz në shkollën “Koli Dimo”, Frashër dhe anasjelltas, për 130 (njëqind e tridhjetë) ditë mësimore.
3. Të miratojë fillimin e procedurave për marrjen me qera të një objekti privat në Zharrëz për zhvillimin e procesit mësimor për arsimin fillor të shkollës së bashkuar “Sotir Çapo”.

4. Të miratojë fondin prej 320,000 (treqind e njëzetë mijë) lekë për mbulimin e qerasë së një objekti për zhvillimin e procesit mësimor për arsimin fillor (klasa 1-5) me një numër prej 58 (pesëdhjetë e tetë) nxënës për një periudhë të parashikuar 8 (tetë) mujore.
5. Bashkëlidhur relacioni i llogaritjes së kostove të transportit.
6. Shpenzimet do të mbulohen brenda programit të “Arsimit bazë” nga çlirimi i fondit të objektit “Rikonstruksioni kopshtit me drekë, Patos”.

Drejtuesi i Programit

“Arsimi Bazë”

Dr. Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit

Mitjon Nikolla

Dr. Finance

Mimoza Shtëmbari

Zv. Drejtor i Arsimit dhe Kulturës

Fatjon Mici



Juriste

Nurkë Hazizaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

DREJTORIA E MBROJTJES SOCIALE DHE POLITIKAVE TË ARSIMIT

Nr. 2889/5 Prot.

Patos, më 16/08 /2025

**RELACION
PËR
MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË NXËNËSVE TË SHKOLLËS "SOTIR
ÇAPO", ZHARRËZ**

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, në pjesën V "Kontratat" dhe kreu VI "Qiraja" të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994, i ndryshuar, në shkresën e miratimit të financimit të projektit "Rikonstruksion i shkollës "Sotir Çapo" dhe ndërtimi i palestrës nr. 2174/1 prot., datë 09.04.2025, në V.K.B Patos nr. 23 datë 26.05.2025, "Për miratimin e projektit me objekt "Rikonstruksion i shkollës "Sotir Çapo" dhe ndërtimi i palestrës" dhe bashkëfinancimin nga Ministria e Arsimit dhe Sportit,

Në shkollën e bashkuar "Sotir Çapo", Zharrëz, Patos do të fillojë rikonstruksioni total i objektit, pasi jemi në fazën e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes së objektit **"Rikonstruksion i shkollës "Sotir Çapo" dhe ndërtimi i palestrës për vitet 2025-2027"**, si pasojë lind nevoja e transferimit të nxënësve të kësaj shkolle me qëllim zhvillimin e procesit mësimor në kushte normale. Në këtë shkollë zhvillojnë procesin mësimor 204 (dyqind e katër) nxënës.

Nisur dhe nga kërkesa e drejtorisë së shkollës së bashkuar "Sotir Çapo", të cilën do ta gjeni bashkëlidhur këtij dokumentacioni, lind nevoja për sigurimin e transportit për 108 (njëqind e tetë) nxënës nga shkollla "Sotir Çapo" në shkollën "Koli Dimo", Frashër.

Për nxënësit e Arsimit Fillor, ciklin e ulët nga klasa 1 deri në klasën e 5 me kërkesën e prindërve dhe stafit mësimor është kërkuar që procesi mësimor të zhvillohet në Zharrëz në një ambjent të përshtatshëm pasi fëmijët janë të vegjël dhe është e vështirë të realizohet transporti për ta. Është kërkuar të sigurohet një ambjent që plotëson kriteret e sigurisë së nxënësve dhe me të gjitha kushtet higjeno-sanitare. Numri i nxënësve nga klasa 1-5 që do të akomodohen në këtë ambjent të marrë me qera është 58 (pesëdhjetë) nxënës.

Pjesa tjetër e nxënësve të klasave 6-12 janë në zonat afër shkollës “Koli Dimo”, Frashër si pasojë nuk është kërkuar transport nga drejtoria e shkollën së bashkuar “Sotir Çapo”, Zharrëz, Patos.

Për sa më sipër iu kërkuar drejtorisë së planifikimit urban dhe monitorimit të shërbimeve të llogarisë koston e transporti të nxënësve/cmimi i biletës vajtje ardhje nga shkolla “Sotir Çapo” në shkollën “Koli Dimo”, Frashër, për 130 (njëqind e tridhjetë) ditë mësimore, dhe në vijim duke parë ecurinë e kontratës dhe realizimin e punimeve të shikohet faza përfundimtare nëse do të nevojitet transporti i nxënësve.

Në total shpenzimi i transportit për 130 ditë mësimore në destinacionin e mësipërm është 1,123,200 (një milion e njëqind e njëzetë e tre mijë e dyqind) lekë sipas tabelës më poshtë:

Nr.	Emërtimi i shërbimit	Nr i nxënësve	Cmimi biletës vajtje-ardhje me TVSH	Vlera në lekë per 1 ditë	Nr. total i ditëve për transport	Vlera në lekë me TVSH
1	Transport nxënësish arsimi bazë klasa 6-9 shk. “Sotir Çapo” në shk. “Koli Dimo”, dhe anasjelltas	68	80	5,440	130	707,200
2	Transport nxënësish Arsimi i mesëm klasa 10-12 shk. “Sotir Çapo” në shk. “Koli Dimo”, dhe anasjelltas	40	80	3,200	130	416,000
	Totali	108	80	8,640	130	1,123,200

Shërbimi i transportit do të jetë në përputhje me legjislacionin e transportit të nxënësve në Republikën e Shqipërisë.

Përsa i përket kërkesës për sigurimin e një ambjenti për zhvillimin mësimor në Zharrëz për nxënësit e arsimit fillor, nisur nga mosha e tyre kërkesa qëndron dhe do të fillojnë procedurat për marjen me qera të një ambjenti privat të përshtatshëm, e cila është si e vetmja zgjidhje pasi nuk disponojmë ambjent të lirë shtetëror. Për këtë qëllim u studiua tregu në zonën përreth shkollës aktuale në ambjentet private.

Një godinë e përshtatshme e ndarë në ambiente përkatëse për pesë klasat dhe pjesën e stafit pedagogjik me jo më pak se 3 tualete, minimalisht është 200 m², dhe cmimi mesatar i qerasë bazuar në tre oferta është 200 lekë/m² në muaj.

Për këtë qëllim është parashikuar fondi prej 320,000 (treqind e njëzetë mijë) lekë për mbulimin e qerasë së një objekti për zhvillimin e procesit mësimor për ciklin e ulët (klasa 1-5) me një numër prej 58 (pesëdhjetë e tetë) plus stafi pedagogjik për një periudhë të parashikuar 8 (tetë) mujore. Qeraja mujore parashikohet të jetë në vlerën 40,000 (dyzetë mijë) lekë/muaj.

Shpenzimet për shërbimet e mësipërme do të mbulohen brenda programit të “Arsimit bazë” nga çlirimi i fondit nga objekti “Rikonstruksioni kopshtit me drekë, Patos”.

Për arsyet e sipërpërmendura i kërkojmë Këshillit Bashkiak Patos:

1. Të miratojë transferimin dhe transportin e nxënësve nga shkolla e bashkuar “Sotir Çapo”, Zharrëz në shkollën “Koli Dimo”, Frashër dhe anasjelltas.
2. Të miratojë fondin prej 1,123,200 (një milion e njëqind e njëzetë e tre mijë e dyqind) lekë për mbulimin e transportit të 108 (njëqind e tetë) nxënësve nga shkolla e bashkuar “Sotir Çapo”, Zharrëz në shkollën “Koli Dimo”, Frashër dhe anasjelltas, për 130 (njëqind e tridhjetë) ditë mësimore.
3. Të miratojë fillimin e procedurave për marrjen me qera të një objekti privat në Zharrëz për zhvillimin e procesit mësimor për arsimin fillor të shkollës së bashkuar “Sotir Çapo”.
4. Të miratojë fondin prej 320,000 (treqind e njëzetë mijë) lekë për mbulimin e qerasë së një objekti për zhvillimin e procesit mësimor për arsimin fillor (klasa 1-5) me një numër prej 58 (pesëdhjetë e tetë) nxënës për një periudhë të parashikuar 8 (tetë) mujore.
5. Bashkëlidhur relacioni i llogaritjes së kostove të transportit.
6. Shpenzimet do të mbulohen brenda programit të “Arsimit bazë” nga çlirimi i fondit të objektit “Rikonstruksioni kopshtit me drekë, Patos”.

Ekipi Menaxhimit të programit “Arsimi Bazë”

Drejtues Programi

Mitjon Nikolla

Antarët:

Fatjona Xoxi

Miranda Mete

Manushaqe Lamaj

Burbuqe Nexha

KRYETAR
Fation Duro